

Kontabiliteti & Taksa

Qershor 2009

Kontabiliteti

Organizimi i kontabilitetit bazohet ne ligjin nr.9228, date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare". Ligji percakton se te gjitha kompanite e biznesit te regjistruara ne shqiperi jane te detyruara te zbatojne Standartet Kombetare te kontabilitetit.

Ligji percakton edhe subjektet qe jane te detyruara te zbatojne standartet nderkombetare te kontabilitetit si me poshte:

- Kompanite e regjistruara ne nje burse te letrave me vlere dhe filialet e tyre subjekt i konsolidimit te llogarive;
- Bankat, shoqerite e sigurimit dhe te gjitha shoqerite te licensuara per te kryer investime ne letrat me vlere;
- Kompanite e medha kur ato tejkalojne kufijet e te ardhurave vjetore mbi 1.250.000.000 ALL dhe numrin mesatar vjetor te punojesve prej 100.

Lutemi vizitoni www.minfin.gov.al per versionin ne shqip te ligjit nr.9228, date 29.04.2004 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Standartet Kombetare te Kontabilitetit jane miratuar me Vendim te Keshillit Kombetar te kontabilitetit Nr. 3, date 17.05.2006. Per me shume informacion vizitoni www.minfin.gov.al

Auditimi

Organizimi Auditit te jashtem financiar bazohet ne ligjin nr.10091, date 5.03.2009. Ligji percakton menyren e organizimit te profesionit auditit te pavarur, regullat e mbikqyrjes publike dhe detyrimin per zbatimin e Standarteve Nderkombetare te Auditimit.

Per me shume informacion vizitoni www.qpz.gov.al

Taksa

Ligji nr.8438, date 28.12.1998 “Per tatimin mbi te ardhurat” percakton te ardhurat e tatishme te kompanive ku perfshihen te ardhurat nga biznesi, ,te ardhurat nga dividenti si dhe fitimet nga shitja e kapitalit. Ky ligj percakton gjithashtu rregullat per tatimin ne burim dhe transferimin e cmimeve.

Perqindja e tatimit eshte 10%.

Ligji percakton gjithashtu se kur kompanite rezultojne me humbje, ajo (humbja) mund te mbarten per tre vitet pasardhse.

Per me shume informacion vizitoni www.tatime.gov.al

* * *

Ligji nr.7928, date 27.04.1995 “Per TVSH” percakton se TVSH eshte e aplikushme per furnizimin e mallrave dhe sherbimeve si dhe per importet e mallrave. Ligji percakton nivelin e TVSH 20%.

TVSH duhet te paguhet deri me 14 te muajit pasardhes.

Per me shume informacion vizitoni www.tatime.gov.al

* * *

Ligji nr.9136, date 11.09.2003 “Per mbledhjen e sigurimeve shoqerore e shendetsore” percakton se punedhensit duhet te llogarisin dhe derdhin kontributet per sigurimet shoqerore dhe shendetsore. Kontributi eshte detyrim qe paguhet pjeserisht nga punedhenesi dhe pjeserisht nga punemarresi.Ligji gjithashtu percakton nje page minimale dhe nje page maksimale per llogaritjen e sigurimeve shoqerore shendetsore.

Per me shume informacion vizitoni www.tatime.gov.al

This information is provided as a guide only and should not be construed as advice. Professional accounting and tax advice should be sought before acting upon any of the point raised in this information.